

KONTRATE SHITBLERJE KAPITALESH

Sot me daten 24/05/2007 para meje noterit te noterise Delvine Shkelqim Haxhi, me zyre ne qender te qytetit mu paraqiten personalishte: ①

SHITESIT: Tatjana Foti, e bija e Faikut, e datelindjes 1968, lindur ne Ballsh dhe banuese ne qytetin e Sarandes, lagja nr.1, me shtetesi shqiptare, me zotesi juridike, e identifikuar me njohje personale.

② Elektra Premti, e bija e Vasos, e datelindjes 1951, lindur dhe banuese ne qytetin e Tiranës, me shtetesi shqiptare, me zotesi juridike per te vepruar, e identifikuar me pasaporten nderkombetare me nr. Z.1494550.

③ Altin Premti, i biri i Stillos, i datelindjes 1973, lindur dhe banues ne qytetin e Sarandes, lagja nr.4, me shtetesi shqiptare, me zotesi juridike, i identifikuar me pasaporten nderkombetare nr. Z1405193.

BLERESI: Lefteri Premti, e bija e Janit, e datelindjes 1953, lindur ne Skrapar dhe banuese ne Sarande, lagja nr.4, me zotesi juridike, me shtetesi shqiptare, e identifikuar konforme ligjit.

Palet me vullnetin e tyre te lire dhe te pavesuar lidhen kete kontrate per shitblerjen e kapitaleve:

Me vendimin nr.26749 date 27/11/2001 te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "PRELLA" SH.P.K.

Me vendimin nr.6 date 24/05/2007 te Asamblese se ortakeve te shoqerise eshte vendosur qe ortakët e kesaj shoqerie zonjat Tatjana Foti dhe Elektra Premti me deshiren e tyre largohen nga shoqeria dhe kuotat e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise qe jane nga 20 per secilen ose nga 20.000 leke ja shesin zonjes Lefteri Premti e cila ne keto kushte futet si ortakë e re ne shoqeri. Po ashtu ortakë i shoqerise Altin Premti po me deshiren e tij ka vendosur qe ti shese 40 kuota ose 40.000 leke nga 60 kuota ose 60.000 leke qe ka ne kapitalin fillestar te shoqerise prej 100 kuota ose 100.000 leke. Ne kushtet e shitjes